

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Minir Hoti, dhe sekretaren juridike Fatmire Podvorica, në çështjen penale kundër të pandehurit **1. R.H.** nga fshati O., komuna e P., **2. F. Sh.** nga fshati B. komuna e P. dhe **3. Z. Sh.** nga fshati B., komuna e P., për shkak se të pandehurit R. H. dhe F. Sh. në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, ndërsa i pandehuri Z. Sh. për shkak se ka kryer veprën penale Pranim i mallrave të vjedhura nga neni 272 par.1 të KPK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.nr.1320/2012 të dt.21.10.2013, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më dt.10.11.2014, shqyrtimit të dytë më dt.12.01.2015 dhe shqyrtimit gjyqësor publik në prani të Prokurorit të shtetit Bukurije Gjonbalaj nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, të të pandehurve R. H., F. Sh., Z. Sh., dhe të dëmtuarit B. N., pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor më dt.12.02.2015, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

1. I pandehuri: **R. H.**, nga i ati H1. dhe nënës H2., e vajzërisë H., i lindur më dt.*data e lindjes...* në fshatin K., me vendbanim në fshatin O., Komuna e P., nr. personal *numër personal...*, i martuar baba i 3 fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptarë-shtetas i Republikës së Kosovës.
2. I pandehuri: **F. Sh.**, nga i ati B. dhe nënës E., e vajzërisë Sh., i lindur më dt.*data e lindjes...* në fshatin B., Komuna e P., ku edhe tani jeton, nr. personal *numër personal...*, i martuar baba i 4 fëmijëve, i pa arsimuar, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptarë-shtetas i Republikës së Kosovës.
3. I pandehuri: **Z. Sh.**, nga i ati H. dhe nënës Xh., e vajzërisë A., i lindur më dt.*data e lindjes...* në fshatin B., Komuna e P., ku edhe tani jeton, nr. personal *numër personal...*, punëtor ndërtimtarie, i martuar baba i 2 fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptarë-shtetas i Republikës së Kosovës.

I. Për të pandehurin Z. SH.

Në kuptim të nenit 363 par.1 nëpar.1.3 të KPPRK-së

REFUZOHET AKUZA

Sepse:

2. I pandehuri Z.Sh., më datën 24.06.2009, televizorin e llojit “Plazma” e ka blerë edhe pse e ka ditur apo ka mundur ta dij se është i vjedhur krahasuar me çmimin që ka paguar dhe çmimin kushtues, këtë e ka bërë me qëllim të përfitimit të pasurisë së huaj në mënyrë të kundërligjshme e ka blerë për 300 €, nga të pandehurit e theksuar më lartë, e i cili ka kushtuar

rreth 1000€, për të cilin i dëmtuari e ka ofruar faturën e dt.30.04.2008 me nr.0014563, e i cili është gjendur në shtëpinë e të pandehurit dhe pas identifikimit të njëjtit, i është kthyer pronarit,-

- Me këtë kishte për të kryer veprën penale Pranim i mallrave të vjedhura nga neni 272 par.1 të KPK-së.

Shpenzimet e procedurës penale lidhur me këtë të pandehur bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

I dëmtuari B. A. N. nga P., rr. “...” pnr., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

II. I pandehuri F. SH.

ËSHTË FAJTORË

Sepse :

1. Më dt.23.06.2009, rreth orës 05:15, në rrugën “Zahir Pajaziti” në P., më saktësisht në lokalin e kafiterisë “E.” pronë e të dëmtuarit B. N., i pandehuri F.Sh., me qëllim me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit ti sjell përfitim pasuror në mënyrë të kundërligjshme, ka depërtuar brenda në hapësirën e lokalit duke e prerë mbrojtësen e metaltë të lokalit me dana metali e pastaj cilindrin të derës së lokalit e ka hapë me pajser, ka hy dhe ka marrë vetëm televizorin plazma “Samsung 107 inc”, e ka dërguar në shtëpinë e tij, e pastaj ia ka shitur për 300€, të pandehurit Z. Sh., me ç’rast të dëmtuarit B. N. i ka shkaktuar dëm material 940,-

- Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 të KPK-së.

Andaj gjykata në kuptim të neneve 6, 11, 34, 38 dhe 64 të KPK-së, si dhe në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, e :

G J Y K O N

Të pandehurit **F. Sh.**, i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej **1(një) viti**, të cilin dënim do ta mbaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shpenzimet paushallë gjyqësorë në shumën prej **50€uro**, brenda afatit prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari B. A. N. nga P., rr. “...” pnr., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

III. I pandehuri R. H.

Në kuptim të nenit 364 par.1 nën par.1.3 të KPPRK-së

LIROHET NGA AKUZA

Sepse: Si në pikën **II.** të dispozitivit të aktgjykimit kishte për të kryer veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 të KPK-së.

- për shkak se nuk është provuar që i akuzuari të ketë kryer këtë vepër penale.
- I dëmtuari B. A. N. nga P., rr. “....” pnr., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Shpenzimet e procedurës penale lidhur me këtë të pandehur bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën PP.II.nr.1320/2012 të dt.21.10.2013, ka akuzuar të pandehurit R. H. dhe F. Sh. se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, ndërsa i pandehuri Z. Sh. për shkak se ka kryer veprën penale Pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 par.1 të KPK-së.

Në shqyrtimin fillestar të mbajtur më 10.11.2014, prokurori i shtetit Atdhe Dema nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, fillimisht ka bërë plotësimin e aktakuzës dhe atë dispozitivin nën II., të kësaj aktakuze me datën e kryerjes së veprës penale e cila do të jetë 24.06.2009.

Meqenëse vepra penale nën pikën II, të dispozitivit të aktakuzës është kryer me datën 24.06.2009 e sipas dispozitave të nenit 272 par.1 të KPK-së, ligjvënësi ka paraparë dënim me burgim deri në 1(një) vit, gjykata pasi shqyrtoi dhe vlerësoj shkresat e lëndës dhe duke vepruar sipas detyrës zyrtare, konstatoi se në rastin konkret është shkaktuar parashkrimi absolut dhe ndalesa absolute e ndjekjes penale, ngase sipas dispozitave të nenit 90 par.1 nën par.6 të KPK-së, vepra penale e cila është e dënueshme deri në një vit burgim ose dënim me gjobë, parashkruhet kur të kalojnë 2 vjet nga data e kryerjes së veprës penale, kurse sipas dispozitave të nenit 91 par.6 të KPK-së, ndjeka penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale), e që në rastin konkret kanë kaluar më tepër se 4 vite dhe parashkrimi absolut i ndjekjes penale ka arritur me dt.24.06.2013.

Në shqyrtimin fillestar të mbajtur më 10.11.2014, i pandehuri F. Sh. e pranoi në tërësi veprën për të cilën akuzohej sipas të gjitha pikave të aktakuzës, ndërsa i pandehuri R. H. është deklaruar i pa fajshëm.

Pas pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit F. Sh., gjykata më pastaj mori mendimin e prokurorit të shtetit Atdhe Dema lidhur me pranimin e fajësisë i cili deklaroi: vlerësoj se pranimi i fajësisë është bërë në pajtim me ligjin dhe atë nenin 248 par.1 të KPP-së, dhe i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe materialin e mbështetur nga ana e prokurorit të shtetit, për plotësimin e aktakuzës së pranuar nga ana e të pandehurit dhe çdo provë tjetër, siç është dëshmia

e dëshmitarëve dhe të pandehurve nga ana e prokurorit. Meqenëse i akuzuari e pranon aktakuzën në tërësi për të gjitha pikat e saj, i propozoi gjykatës që pranimin e fajësisë së të akuzuarit gjatë matjes së dënimit të ia pranoj si rrethanë lehtësuese.

Gjykata pas marrjes së mendimit nga ana e prokurorit të shtetit vlerësoj se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 248 të KPPRK-së, dhe aprovoj pranimin e fajësisë, kurse në bazë të nenit 326 par.5 të KPPRK-së, shpalljen e aktgjykimit për të akuzuarin F. Sh. e bëri pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me 12.02.2015, u dëgjuan Prokurori i Shtetit Bukurije Gjonbalaj nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, i dëmtuari-dëshmitari B.N. dhe i pandehuri R. H..

Prokurori i shtetit Bukurije Gjonbalaj nga Prokuroria Themelore në Prishtinë në shqyrtim kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë aktakuzës se ushtruar ndaj të pandehurit R. H. me provat e siguruar në procedurën hetimore, dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike në bazë të cilës vërtetohet qartë se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, gjendja faktike në këtë veprë penale vërtetohet nga dëshmia e dëshmitari B. N. i cili deklaron se lokali i është thyer me forcë dhe nga ai është marrë televizori Plazma Samsung në vlerë prej 940 Euro, këtë e dëshmon edhe bashkryesi F. Sh. i cili e ka pranuar veprën penale, dhe në mbrojtjen e tij të dhënë në polici dhe para prokurorit ka deklaruar se të njëjtën veprë e ka kryer se bashku me të akuzuarin R. H. dhe kryerjen e veprës penale e ka përshkruar në mënyrë të qartë ashtu siç ka ndodhur në vendin e ngjarjes ku shihet edhe nga foto dokumentacioni që është në lëndë, mbrojtjen e të akuzuarit R. H. gjykata duhet ta marrë si të pa bazuar se me këtë i pandehuri mundohet të ikë përgjegjësisë penale, kjo duke u bazuar edhe në deklaratën e dhënë në prokurori dhe në mbrojtjen e sotme gjatë shqyrtimit gjyqësor e cila është kontradiktore sa i përket njohjes së bashkëkryesit i cili në prokurori ka thënë se e kam njohur, ndërsa tani gjatë shqyrtimit gjyqësor thotë se për të njëjtin kam dëgjuar vetëm pas informimit të kryerjes së veprës penale, kështu që në bazë të kësaj vërehet se i pandehuri në këtë mënyrë mundohet të ikë përgjegjësisë penale, gjykata duhet të ketë për bazë dëshminë e dëshmitarit - të dëmtuarit prova tjera që gjenden në shkresat e lëndës si dhe thënien e bashkryesit i cili ka qene në të dy deklaratat ka qene shume i njëjtë ka dëshmuar njëjtë, dhe thëniet e tij lidhen me provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës, kështu që nga të gjitha këto rezultojnë se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar andaj i propozoi gjykatës që të njëjtin të shpalli fajtor dhe të dënoj sipas ligjit.

I dëmtuari B. N. lidhur me kërkesën pasurore juridike në fjalën përfundimtare ka deklaruar se parashtrij kërkesë pasurore juridike, mirëpo nuk kam dëshmi përveç ato që i ka prokuroria mbi lartësinë e dëmit.

Në procedurën e provave gjykata dëgjoi të dëmtuarin-dëshmitarin B. N., u lexuan deklaratat dhe informacionet e siguruar në procedurën parapenale, si dhe foto dokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës.

Në shqyrtim gjyqësor i dëmtuari B. N. i dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit ka deklaruar se më datën 23.06.2009, rreth orës 05,20 të mëngjesit jam zgjuar për të hapur lokalin, ndërsa para

lokalit kishin qenë 2 policë, mbrojtëset e lokalit kishin qenë të prera, dera e thyer dhe cilindri, ndërsa brenda lokalit mungonte televizori i cili ka qene i vendosur ne mbajtëse të murit. Nuk kam dyshuar ne askënd. Te akuzuarin që gjendet në gjykatore nuk kam njohur me herët dhe nuk mundem te dije se a ka qene ndonjëherë ne lokal apo jo.

I akuzuari R. H. në shqyrtim gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare është deklaruar i pafajshëm dhe ka kërkuar nga gjykata që ta liroi nga akuza edhe atë sepse kjo aktakuzë është e pa bazë nuk ka fakte, pa asnjë provë, por vetëm me fjalë, kërkoj nga gjykata ti merr parasysht provat dhe fjalën e të akuzuarit F. Sh. gjatë shqyrtimit të parë që ka deklaruar të vërtetën që vjedhjen e ka kryer vetëm. Unë këtë veprë penale nuk e kam kryer, sepse po të kisha kryer e kisha pranuar, ashtu siç kam vepruar në një rast tjetër ku e kam pranuar fajësinë. Edhe njëherë deklaroj se jam plotësisht i pa fajshëm dhe kërkoj nga gjykata që të me liroj nga kjo aktakuzë.

Gjykata i ka dhënë besimin e plotë deklaratës së dëshmitarit B. N. i cili nuk ka dyshuar dhe nuk e ka inkriminuar të pandehurin R. H. për thyerjen e mbrojtëses së lokalit dhe vjedhjen e kryer, e në këtë rast vjedhjen e televizorit i cili ka qenë në lokal.

Duke bërë leximin e deklaratave dhe informacionet e siguruar në procedurën parapenale shihet se i pandehuri R. H. në asnjë mënyrë nuk ka pranuar kryerjen e veprës penale, por vetëm është i apostrofuuar si bashkëkryerës nga i pandehuri tjetër F. Sh., i cili në shqyrtimin fillestar të mbajtur pranë kësaj gjykate me dt.10.11.2014, e ka pranuar në tërësi fajësinë për kryerjen e veprës penale sipas të gjitha pikave të aktakuzës dhe ka theksuar se ai i vetëm e ka kryer veprën penale.

Ndërsa nga foto dokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës vetëm mund të konstatohet se si është prerë mbrojtësja e lokalit, si është thyer cilindri i derës së lokalit dhe është depërtuar në brendi të lokalit, ku është kryer vjedhja, pra nga foto dokumentacioni në përgjithësi mund të dokumentohet pamja fizike ku është kryer vjedhja, pasojat, por të njëjtat me asnjë gjurmë nuk vërtetojnë se i pandehuri R. H. e ka kryer veprën penale.

Andaj, nga provat e administruara në mënyrë të pa dyshimtë vërtetohet se i pandehuri R. H. nuk e ka kryer veprën penale në bashkëkryerje, por këtë e ka bërë i vetëm i pandehuri F.Sh. siç është vërtetuar me pranimin e fajësisë nga ana e tij.

Gjykata ia ka dhënë besimin e plotë deklaratës se të pandehurit sepse i njëjti me të vërtetë me deklaratën e vetë në të gjitha fazat e procedurës para policisë, para prokurorit si dhe gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor ka vërtetuar se nuk ka qenë kryerës apo bashkëkryerës i veprës penale për të cilën akuzohet.

Me provat e nxjerra gjate shqyrtimit gjyqësorë në tërësi nuk është vërtetuar se i pandehuri R. H. ka kryer veprën penale qe i vihet ne barrë me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë.

Pasi qe nuk është vërtetuar se i pandehuri e ka kryer në bashkëkryerje veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, për këtë arsye gjykata e ka liruar nga akuza në bazë të nenit 364 par.1 nën par.1.3 te KPPRK-së.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin për të pandehurin F. Sh. gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat konform nenit 64 të KPK-së ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ashtu që si rrethanë lehtësuese mori pranimin e fajësisë, ndien keqardhje për veprën e kryer, i kërkon falje të dëmtuarit për dëmin e shkaktuar, gjendjen e tij të dobët ekonomiko-sociale, ndërsa si rrethanë rënduese mori se i akuzuari edhe më parë ka qenë i dënuar për vepër penale Vjedhje, është recidivist i veprave të ngjashme, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, motivin për kryerjen e veprës, shkallën e rrezikimit apo dëmtimit të së mirës së mbrojtur, andaj të njëjtin e gjykoi si në dispozitiv të aktgjykimit me bindje se dënimi i shqiptuar është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer dhe shkallën e përgjegjësisë të të akuzuarit, dhe se me këtë dënim do të bëhet risocializimi i tij dhe se do të jetë si preventivë për të dhe të tjerët të mos kryejnë vepra penale të tilla apo të ngjashme, e që është qëllimi i dënimit nga neni 34 i KPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor për të pandehurin F. Sh. u mor në bazë të nenit 450 par.1 dhe 2 pika 2.1. dhe 2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së, ndërsa vendimi për të pandehurit Z. Sh. dhe R. H. vendimi mbi shpenzimet u mor në bazë të nenit 454 par.1 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
P.nr.942/2013 më dt.12.02.2015

Sekretarja juridike :
Fatmire Podvorica

Gjyqtari :
Minir Hoti

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimin të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.